REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 725/20
Datë/Datum. 14.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi ***Dior Halili***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***02/10/2020***	*Data e dorëzimit të raportit* ***14/10/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.09.2020, **OE "NTP Miri" Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **725/20**, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN"** me nr. të prokurimit: **KOSTT-20-3500-2-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **OPER. SISTEMI,TRANS.DHE TREGU- KOSTT SH.A.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: procedurë e hapur, lloji i kontratës: shërbime (kontratë publike kornizë me një operator), ndarja në pjesë: jo, vlera e parashikuar e kontratës: 38,000€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.
Data e njoftimit për kontratë (në Eprokurim): 09.07.2020
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë publike kornizë shërbim
Vlera e parashikuar e kontratës:..... 38,000.00€
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët - Pas kategorizimit!
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ..... 04.08.2020 koha 10:00
Data e hapjes se ofertave .....,,..... 04.08.2020 koha 10:00
Data e Njoftimit për Vendimin e AK 14.09.2020
Data e Kërkesës per rishqyrtim 17.09.2020
Data e përgjigjes sw Kërkesës per rishqyrtim 17.09.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datën: 27.09.2020, **OE "NTP Miri" Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **725/20**, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN"** me nr. të prokurimit: **KOSTT-20-3500-2-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **OPER. SISTEMI,TRANS.DHE TREGU- KOSTT SH.A.**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:
Sipas Tenderusit NTP „Miri" nga Prishtina, Autoriteti Kontraktues, ka bërë shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, më tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht:

- Neni 1 LPP-së : (Qëllimi);
- Neni 6, LPP-së : (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
- Neni 7: (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi),
- Neni 56: (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave)
- Neni 59: (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)
- Neni 61 i LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët)

Ne me date 14.09.2020 Autoriteti Kontraktues (AK) ka publikuara NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES dhe kemi pranuar Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përmes se cilës pretendohet se kinse ne si tenderues kemi dorëzuar tender Jo-normalisht të ulët, citojmë:

Tenderi i juaj nuk është i përgjegjshëm për arsye se: Edhe pse pas kërkesës për sqarime të çmimeve jo normalisht të ulëta, Ju si OE nuk keni arritur të na bindeni neve si AK KOSTT, prandaj konform Nenit 61.1 dhe 61.4 të LPP-së dhe oferta e Juaj refuzohet si Jo-normalisht e ulët

Në vazhdim NTP „Miri", nga Prishtina, Ju prezanton Pikat e ankesës, për shkeljet e bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjat vlerësimit të tenderit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", duke e anuluar proceduren e prokurimit, per shkak se nuk kemi asnje ofertë të përgjegjshme, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti merr parasysh në shpjegimin dhe arsyetimin në vijim:

- Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 1 të LPP-së (Qëllimi), sepse me rastin e anulimit të procedurës së prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit . Me këtë rast Autoriteti kontraktues e nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 1 të LPP, që e

ka për obligim që siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik për vendimet e marra, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike.

- Kompania e jonë mendon se me këtë rast është shkelur Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), sepse Autoriteti kontraktues, me vendimin e marrë për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe eliminimin tonë për këtë tender nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 6 të LPP –së, citojmë:
  Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
  Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues, nuk ka vepruar ne pajtueshmëri me Nenin 6 të LPPsë, sepse me me vendimin e marrë për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe eliminimin tonë për këtë tender kinse kemi dorëzuar oferte si Jo-normalisht e ulët, i kanë ikur obligimit që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike.

Tenderusi, NTP „Miri", mendon se me këtë rast është shkelur neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), sepse Autoriteti kontraktues, me këtë rast, me vendimin e marrë për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe eliminimin tonë për këtë tender, na ka vu në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese me këtë veprim, sepse kompania e jonë për këtë shërbim, ka ofruar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe ka deklaruar me argumente, se qëndron prapa çmimeve dhe ofertës së dhënë.

Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 56 i LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji;

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të

ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në këtë nen të cekur më lartë ne mendojmë se Autoritetit Kontraktues ka dështuar në vlerësimin e tenderit tonë, duke na eliminuar pa të drejtë, kinse Oferta e jonë është e papërgjegjshme për arsye se kemi dorëzuar oferte si Jo-normalisht e ulët. AK pa dashje apo jo qellimisht, nuk i ka dhene rendesi Kriterit Cmimi ma i ulet pas kategorizimit, sepse oferta jone eshe dukshem me e lire se ofertat tjera te pergjegjshme te pranuara nga ana e AK. Pra, pasi qe kontrata per sherbime te mirembajtjes se automjeteve, eshte Kontrate qe zhvillohet sipas nevojes apo kur paraqitet nevoja e intervenimit, apo ne raste te parandalimit, mendojme qe KOSTT eshte ngutur duke na eliminuar duke mos marr parasysh sqarimet tona te dates 09.09.2020

Tenderusi, NTP „Miri", ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues ka shkelur nenin 59 i LPP-së -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, të cilat kërkesa tenderi i jonë, i ka plotësuar të gjitha

Tenderusi, NTP „Miri", ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues, me rastin e eliminimit të tenderit tonë me arsyetimin, citojmë :

Tenderi i juaja nuk është i përgjegjshëm për arsye se: Edhe pse pas kërkesës për sqarime të çmimeve jo normalisht të ulëta, Ju si OE nuk keni arritur të na bindeni neve si AK KOSTT, prandaj konform Nenit 61.1 dhe 61.4 të LPP-së dhe oferta e Juaj refuzohet si Jo-normalisht e ulët.

Ky vlerësim sipas neve nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse është shkelur Neni 61 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) dhe nuk janë marrë me elementet tjera të shqyrtohen, sepse nuk kemi të bëjmë me çmim Jo normalisht të ulët, sepse të gjitha ofertat janë të përafërta.

Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht te ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Në pajtueshmëri me Rregullat per Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pas kërkesës nga ana e Autoritetit Kontraktues kemi dhënë sqarime përmes Letres Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulet, ju kemi dërguar përgjigje dhe shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tonë.

Ne mendojme qe ne sqarimet teknike qe i kemi derguar e dt.09.09.2020 ishim mjafte te qate, se ne si kompani, seriozisht i jemi qasur ketij projekti. Mirembajtja e automjeteve eshte biznes primar i joni, dhe e njohim mjafte mire natyren e mirembajtjes, prishjet, arsyet qe qojne deri ne prishjet eventuale. Prandaj qendrojme pas atyre cmimeve qe kontrata do te ishte realizua pa asnje problem gjate periudhes 36 mujore.

Çmimet e dhëna për këtë tender, bazohen në Politikat e çmimeve të firmës NTP„MIRI" me synimin që totali

i dhëne për të gjitha pjesët të ketë një bilanc pozitive me një fitim minimal.

Mendojme qe keqkuptimi i cmimeve te ofertuara nga NTP :"Miri"si kompani serioze ka te beje edhe me specifikim teknik qe ishte pjese e tender dosjes. Tabelat e ofertimit ne nje vend i kishin te vendosuar pjesen e ndrrimit dhe te sherbimit, dhe ne disa pozicione ka pjese te cilat nuk i perkasin automjeteve te precizuara per ofertim.

Sidoqofte, ka mjafte ndarje, ku mvaresisht prej prishjes, ato kombinohen ne menyre qe te arrihet realizimi i sukseshem i sherbimit.

Prandaj, cmimet qe ka mujt te i konsideroj AK si jo normalisht e uleta, ato te jane si pjese komplementare me pjese tjera, qe te realizohet sherbimi i plote i intervenimit ne automjet.

Ne me këto çmime, të cilat për neve janë çmime të tregut, kemi kontrata të shumta me Institucione të shumta të qeverisë së Kosovës, të cilat jemi duke i realizuar me sukses, për çka tregojnë edhe referencat e lëshuara për realizimin e suksesshëm të këtyre kontratave, të cilat janë të bashkangjitura në këtë tender.

Të gjitha kto elemente përbërëse të tenderit i kemi sqaruar mjaftueshëm dhe Autoriteti Kontraktues është dashtë ti marrë në konsideratë, ta trajtojë tenderin e tenderuesit NTP„MIRI" të përgjegjshëm

Andaj, pas këtyre argumenteve të prezantuara më lartë, për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi anulimin e aktiviteti i prokurimi për tenderin "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1 dhe numri i brendshëm: KOSTT5323/1/2-20-42-221 dhe lënda të kthehet në Ri vlerësim

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Letra standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët dërguar nga AK drejt OE ankues ku kërkohet që këta të fundit të japin shpjegim të elementeve përbërëse të tenderit.*

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve të llojit: LANDROVER, NISSAN dhe FORD					Çmimi i pjesës dhe shërbimit
18	Boschpumpa	1	copë	1	2.29
41	Kapaku gjysmë boshtit	1	copë	1	1.30
42	Kardani komplet (I)	1	copë	1	1.25
43	Kardani komplet (II)	1	copë	1	1.35
46	Kompjuteri i automjetit	1	copë	1	12.29
52	Kushineta shtytëse (Drukllageri)	1	copë	1	1.32
55	Mbajtësi i sponave	1	copë	1	1.35
60	Pastrimi i Sistemit EGR (set)	1	set	1	1.25
61	Piruni (viljushka) i ndërruesit të shpejtesive	1	copë	1	2.25
62	Piruni i Drukllagerit	1	copë	1	2.35
63	Piruni (vilusska)	1	copë	1	1.25
65	Pulendë (Remenicë) Alternatori me xhunto (Lamela)	1	copë	1	1.25
66	Qikriku (tamburi) vet tërheqës elektrik	1	copë	1	1.25
67	Reduktori	1	copë	1	2.35
70	Reketa e dritave (ablender)	1	copë	1	2.50
71	Reketa e tregnesve	1	copë	1	3.35
78	Rripi i klimës	1	copë	1	1.32
84	Shporta (Korpa) e Xhuntos (Lameles)	1	copë	1	35.00
86	Spona e gjatë	1	copë	1	1.25
89	Spona qendrore	1	copë	1	1.50
92	Testimi i Boschpompës	1	copë	1	1.30
93	Testimi i Dizenve	1	copë	1	1.20
94	Valvula qitëse	1	copë	1	1.30
95	Valvula thithëse	1	copë	1	1.30
99	Zinxhirët e motorit	1	komplet	1	1.25
127	Auspuhi - pjesa e parë	1	copë	2	2.00

Fakt 2: *Përgjigja e OE ankues ndaj Kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët.*

Po Ju dërgojmë përgjigje dhe shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tonë, si në vijim:

Çmimet e dhëna për këtë tender, bazohen në Politikat e çmimeve të firmës respektive (NTP„MIRI) me synimin që totali i dhëne për të gjitha pjesët të ketë një bilanc pozitive me një fitim minimal.

Ne kemi krahasuar llojet e automjeteve dhe modelin e tyre dhe në përgjithësi konsiderojmë që janë vetura për të cilat kemi pjesë rezervë dhe per Servisime në stoqe të mjaftueshme, për të përmbushur kërkesat e mundshme që do dalin nga ana juaj në çdo kohë, sepse për veç tjerash ne kemi bashkëpunim dhe kontrata afatgjate më prodhues dhe kompani të cilat merren me shumicë me pjesë rezervë për automjete.

Me këtë ju konfirmohet që firma NTP„MIRI" qëndron prapa çmimeve të dhëna në propozimin financiar dhe me kënaqësi do të dëshmonim profesionalizmin tonë në ketë drejtim.

Në vazhdim po ju japim sqarimin detal edhe sipas artikujve dhe pozicioneve :

18.Boshpumpa, /ne ketë rast kemi einshpric pumpe pompë elektronike

41.Kapaku i gjysmë bushtit /është vetëm një kapak metalik qe është çmim i arsyeshëm

42/43. Kardoni I-II / këtu kemi vetëm pjesën metalike defektet paraqiten te koka e kardonit kryqi

52.Kushineta shtytëse / ketë e zëvendëson cilindri i kupllungut qe është cilindër me vaj.

55. Mbajtësi i sponave / është fjala për sponen kryesore ku e kemi ne liste me poshtë.

60.Pastrimi I sistemit te EGR / është vetëm shërbim i lehte pastrim.

61/62 Piruni I ndërruesit-Piruni drugllagerit / është një pjese metalike e njëjtë ne dy rastet çmimi është i arsyeshëm.

65.Polexhe e alternatorit/ përsëritet nga numri rendor 51 kushinetë e shtrënguesit Alternatorit.

78.Rrypi i klimes / Perseritet kemi nr 75 rripi i ac klimës.

92.Testimi i boshpumpes /Është fjala einshpric pumpe është vetëm shërbim.

93.Testimi I dizneve/është vetëm shërbim testim ku llogaritet për cope është çmim i arsyeshëm.

127.Auspuhi pjesa e pare /këtu kemi një pjesë e cila quhet Sita e Auspuhit.

130/131/132/133 Automati, shtopave, rikfercit, indikatorit, ftofsit disa nga ta nuk I posedon automjeti.

151.Flutra e klimës /këtu kemi një flutur te përbashkët me Fluturën e motorit.

155.Gjysem boshti pollosovine / është pjesa e metaltë dhe shumicën e rasteve ndërrohet Nyja zgllobi.

177/178.Pastrimi I injektorit , pastrimi i boshpompes / është shërbim ku llogaritet për cope është çmim I arsyeshëm pastrimi.

203.instalimi elektrik /*përsëritet te nr110 riparimi I instalimit elektrik si dhe është instalimi për secilën pjesë si. Instalimi I dritave, shtopave nxemsave ne listën e çimeve.

207 Riparimi I anlaserit/ e kemi te 250 riparimi I anlaserit ku përfshihet edhe mbështjellja e rotorit.

214/215.Sistemi I alarmit/sistemi I mbylljes se dyerve këtu nënkupton rregullimi I instalimit elektrik ku e kemi me lart ne tabelë.

228.Polirimi I automjetit/ edhe këtu e kemi vetëm shërbim ku e kryejmë për secilin konsumator me çmim simbolik.

231.Riparimi I boshpumpes / këtu kemi një pompe elektrike ku kemi sqarua edhe me larte.

235.Akordimi I valvuleve është shërbim masë ndërrimit te valvuleve ke llogariten pjesët e shërbimi.

237/238.Diktuni I kapakut/I karterit është vetëm me silicon nuk ka diktun klasik sit e modelet e vjetra.

283.ndrruesi I shpejtësive /është fjala për Marshin, menjaqin është çmim i arsyeshëm.

306/307 Koshi i pare –pasmë /këtu behet fjalë për karoseri kjo ndodhe vetëm pas ndonjë aksident, ku i kemi ne listën e çmimeve edhe pjesët përcjellëse te dëmit si riparimet dhe ngjyrosjet.

Ne me këto çmime të cilat për neve janë çmime të tregut, kemi kontrata të shumta me Institucione të shumta të qeverisë së Kosovës, të cilat jemi duke i realizuar me sukses, për ça tregojnë edhe referencat e lëshuara për realizimin e suksesshëm të këtyre kontratave, të cilat janë të bashkangjitura në këtë tender.

Ju si autoritet kontraktues veç keni kërkuar sigurinë e ekzekutimit 10% te vlerës së kontratës. Në rastet e caktuara sidomos kur konsideroni qe një kontratë mund te jete me rrezik të përmbushjes mund të kërkoni që siguria e ekzekutimit të dorëzohet edhe në një vlerë me te lartë dhe ne do te ju përgjigjemi pozitivisht.

Nëse Autoriteti Kontraktues vlerëson të nevojshme edhe për sqarime tjera shtesë, Ne do jemi në dispozicion gjatë gjithë kohës.

Me respekt,

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Paraprakisht. Eksperti vlerëson që konform nenit 1 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht te ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që Autoriteti Kontraktues pa të drejtë i ka eliminuar si OE të papërgjegjshëm edhe pas përgjigje ndaj Kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shkresave zyrtare gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar, duke arsyetuar si në vijim:

- Autoriteti Kontraktues është dashur që Konform nenit 12 të RRUOPP për Parashikimin e vlerës dhe klasifikimin e kontratës ku thuhet që "vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike", të përcaktojë vlerë të arsyeshme për kontratën e parashikuar. Një vlerë e tillë për këtë aktivitet të prokurimit rezulton të jetë 38,000 EUR, me kohëzgjatje të kontratës publike kornizë prej 36 muajsh. Marrë parasysh ofertën e OE ankues brenda vlerës së parashikuar së kontratës publike kornizë përkundër sasisë indikative dhe mospërputhjes së lejuar me plus/minus tridhjetë përqind (30%), interpretimi i ofertave pjesëmarrëse, gjegjësisht cmimit të tyre pas kategorizimit si jo-normalisht i ulët nga Autoriteti Kontraktues jo domosdoshmërisht përkon me dispozitat ligjore të shënuara tek Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.
- Konform nenit 4 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, gjegjësisht **"Procedura e shqyrtimit *(inter partes)*"**, Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë zgjidhjet teknike të ofruara, ekonominë e procesit të shërbimeve të ofruara dhe cfarëdo kushte të tjera të favorshme që janë vendosur në dispozicion nga OE për kryerjen e shërbimeve. Si rezultat, përcaktimi i cmimit të tenderit si ekonomik dhe përmbajtësor me cmimet e tregut është nën diskrecionin e Autoritetit Kontraktues.
- Eksperti vlerëson që përgjigja e OE ankues ndaj Letrës Standarde të kërkesës për informata mbi

tenderët jo-normalisht te ulet dërguar nga AK përmban informata të cilat i adresohen pyetjeve të AK-së, ku në rast të mos-detajizimit të mirëfilltë të pyetjeve rekomandohet që AK të kërkojë sqarime shtesë konform dispozitave ligjore në fuqi. Po ashtu, bazuar në nenin 30.4 të RRUOPP të Sigurisë së Ekzekutimit të Tenderit, Autoriteti Kontraktues pasi që të jetë përputhur me nenin 61 te LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht te ulet), gëzon te drejten qe përqindjen e kërkuar te sigurimit te ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi për anulim të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN" me nr. të prokurimit: "KOSTT-20-3500-2-2-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: OPER. SISTEMI,TRANS.DHE TREGU- KOSTT SH.A., të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **OPER. SISTEMI,TRANS.DHE TREGU- KOSTT SH.A**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **"NTP Miri" Prishtinë**